



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
MINISTRI

Nr. 4140 Prot.

Tiranë, 15.08.2013

U D H Ë Z I M

Nr. 40, datë 15.08.2013

PËR PROCEDURAT E EMËRIMIT DHE SHKARKIMIT TË NËNDREJTORIT
TË INSTITUCIONIT ARSIMOR PUBLIK

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 5 të nenit 55 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

KREU 1

EMËRIMI I NËNDREJTORIT

**I. SHPALLJA E VENDIT VAKANT PËR NËNDREJTOR NË INSTITUCIONIN
ARSIMOR PUBLIK**

Drejtori i institucionit arsimor publik dhe njësia arsimore vendore përkatëse, brenda tri ditëve kur vendi i nëndrejtorit është i lirë, shpallin vendin vakant në faqet elektronike zyrtare të institucionit arsimor publik dhe të njësisë arsimore vendore, si edhe në mjediset e tyre publike.

II. KRITERET PËR NËNDREJTORIN E INSTITUCIONIT ARSIMOR PUBLIK.

Kandidati për nëndrejtor i institucionit arsimor publik duhet:

- a) të ketë diplomë të ciklit të dytë në fushën e edukimit ose diplomë të njëvlershme me të, sipas ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Të ketë licencën pas kalimit me sukses të Provimit të Shtetit. (nëse i takon marrja e licencës)
- b) të ketë të paktën kategorinë “mësues i kualifikuar”;
- c) të mos ketë masa disiplinore në fuqi;

- d) të ketë punuar në arsimin parauniversitar të paktën 5 vjet pa ndërprerje deri në datën e aplikimit.
- e) të jetë vlerësuar të paktën “shumë mirë” në provimin e kualifikimit. (nëse i është nënshtruar këtij provimi).

III. DOKUMENTACIONI I APLIKIMIT DHE AFATI I DORËZIMIT

- 1. Dokumentacioni i aplikimit për nëndrejtor përmban:
 - a) CV-në dhe kopjet që dëshmojnë pohimet në CV (Sipas modelit në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur këtij Udhëzimi).
 - b) Deklaratën personale që vërteton se nëndrejtori nuk ka lidhje familjare me drejtorin e institucionit (bashkëshort/bashkëshorte, prind, vëlla/motër, fëmijë në moshë madhore, prindër të bashkëshortit/bashkëshortes).
 - c) Dy rekomandime nga mësues ose drejtorë të institucioneve arsimore ose titullarë të njësive arsimore vendore që kanë punuar me aplikantin gjatë viteve të fundit (Sipas modelit në shtojcën nr. 2, bashkëlidhur këtij Udhëzimi).
- 2. Dokumentacioni i aplikimit, i përcaktuar në pikën 1, dorëzohet në drejtorinë e institucionit arsimor publik.
Afati i dorëzimit të dokumentacionit është 15 ditë pas shpalljes së kërkesës për nëndrejtor.

IV. PROCEDURA E EMËRIMIT TË NËNDREJTORIT NGA DREJTORI I INSTITUCIONIT ARSIMOR PUBLIK

- 1. Drejtori i institucionit arsimor publik:
 - a) shqyrton dokumentacionet e aplikantit dhe brenda pesë ditëve nga data e dorëzimit të një aplikimi e kthen, kur konstaton parregullsi;
 - b) afishon në sallën e mësuesve të shkollës CV-të e secilit kandidat për nëndrejtor;
 - c) mbledh këshillin e mësuesve dhe kërkon pëlqimin e anëtarëve të tij për secilin kandidat;
 - d) shpall kandidatin fitues, në një mjedis të dukshëm të institucionit arsimor, pasi dëgjon vlerësimet e paraqitura në këshillin e mësuesve.
- 2. Mbledhja është e vlefshme kur marrin pjesë të paktën 3/5 e anëtarëve të këshillit të mësuesve.
Në mbledhje janë të pranishëm kryetari i bordit dhe kryetari i këshillit të prindërve të institucionit arsimor.
- 3. Protokollin e mbledhjes së këshillit të mësuesve i bashkëngjitet vendimit të drejtorit për emërimin e nëndrejtorit.
- 3. Kandidatët jofitues kanë të drejtë që brenda dy ditëve nga shpallja e kandidatit fitues, t'i paraqesin ankesat drejtorit të institucionit përkatës.
Ankesat bëhen vetëm për zbatimin e këtij Udhëzimi.
Drejtori shqyrton ankesat dhe jep përgjigje brenda dy ditëve pas afatit të fundit për ankim.

4. Drejtori i institucionit arsimor publik emëron nëndrejtorin e institucionit arsimor. Vendimi i emërimit i njoftohet zyrtarisht nëndrejtorit të sapoemëruar, titullarit të njësisë arsimore vendore dhe këshillit të mësuesve.

V. RASTE TË VEÇANTA

Në rastet kur nuk paraqiten aplikantë ose ka vetëm një aplikant për vendin vakant, institucioni arsimor publik rishpall menjëherë kërkesën për vendin vakant sipas procedurës së mësipërme.

KREU 2

SHKARKIMI I NËNDREJTORIT

RASTET E SHKARKIMIT TË NËNDREJTORIT TË INSTITUCIONIT ARSIMOR PUBLIK

1. Drejtori i institucionit arsimor publik shkarkon nëndrejtorin në rastet e shkeljeve flagrante, ose kur ka një vendim të formës së prerë nga gjykata për rastet e mëposhtme:
 - a) Falsifikim i dokumenteve zyrtare.
 - b) Nxitje e mësuesve për falsifikim të dokumenteve zyrtare.
 - c) Ushtrim i dhunës fizike ndaj nxënësve ose punonjësve të institucionit.
 - d) Ngacmime seksuale ndaj nxënësve ose punonjësve të institucionit.
 - e) Përvetësim i fondeve financiare ose materiale të institucionit.
 - f) Marrje ryshfetesh.
 - g) Deklarim i rremë në procesin e aplikimit.
 - h) Organizim dhe dhënie kopje në provimet kombëtare, ose shkelje e procedurave të zhvillimit të provimeve kombëtare.
 - i) Ndërhyrje në përzgjedhjen e teksteve nga mësuesit e institucionit.
2. Drejtori i institucionit arsimor publik kërkon pëlqimin e këshillit të mësuesve për shkarkimin e nëndrejtorit, kur nëndrejtori:
 - a) kryen veprime të tjera në papajtueshmëri me legjislacionin në fuqi dhe me udhëzimet e urdhrat e ministrit të Arsimit dhe Shkencës;
 - b) kryen veprime të papajtueshme me rregulloren e brendshme të institucionit arsimor;
 - c) nuk realizon, në mënyrë të përsëritur, përgjegjësitë e tij dhe detyrat e ngarkuara nga drejtori.
3. Drejtori i paraqet paraprakisht këshillit të mësuesve një material ku përshkruhen hollësisht faktet që lidhen me pikat a), b) ose c).
4. Mbledhja e këshillit të mësuesve është e vlefshme kur marrin pjesë të paktën 3/5 e anëtarëve të këshillit të mësuesve.

Anëtarët e këshillit të mësuesve diskutojnë argumentet e drejtorit, duke dhënë pëlqimin ose mospëlqimin e tyre për shkarkimin e nëndrejtorit.

Protokolli i mbledhjes së këshillit të mësuesve i bashkëngjitet vendimit të drejtorit për shkarkimin e nëndrejtorit.

5. Pas shqyrtimit në këshillin e mësuesve, sipas rastit, drejtori i institucionit arsimor vendos shkarkimin e nëndrejtorit ose i jep nëndrejtorit një vit të plotë shkollor provë me detyra të matshme.
6. Nëndrejtori ka të drejtë të dëgjohej nga drejtori i institucionit arsimor, para se të merret vendimi i shkarkimit të tij.

KREU 3

DISPOZITA TË FUNDIT

Procedurat e emërimit dhe shkarkimit të nëndrejtorëve janë objekt i inspektimit të Inspektoratit Shtetëror të Arsimit.

Ngarkohen për zbatimin e këtij Udhëzimi Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore.

Ky Udhëzim hyn në fuqi pasi botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI

MYQEREM TAFAJ

